

VENDIM
Nr. 329, datë 18.12.2025

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 220, DATË 23.10.2024, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘PARISOL’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2540/4 prot., datë 17.12.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 220, datë 23.10.2024, ‘Mbi licencimin e shoqërisë shoqërinë ‘PARISOL’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw””,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Parisol” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 220, datë 23.10.2024, ka licencuar shoqërinë “Parisol” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet prodhues 2 mw, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.

- Në pikën 2, të vendimit nr. 220/2024, është përcaktuar se: “Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike jo më vonë se data 28.9.2025”.

- Gjithashtu, në pikën 3 të këtij vendimi përcaktohet se: “Ky vendim është objekt rishikimi në rast se shoqëria nuk fillon operimin e centralit brenda afateve të përcaktuara në nenin 9, të kontratës nr. 10511 rep., nr. 4874 kol., datë 28.12.2023, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të depozitohet një qëndrim i MIE-s, në lidhje me vlefshmërinë e kësaj kontrate”.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- ERE, me shkresën nr. 2540 prot., datë 29.9.2025, iu drejtua shoqërisë “Parisol” sh.p.k., duke i kërkuar të paraqesë informacionin përkatës lidhur me zbatimin e pikës 2 të këtij vendimi.

- Në përgjigje të kësaj shkrese, shoqëria “Parisol” sh.p.k. me shkresën nr. 19 prot., datë 8.10.2025, protokolluar në ERE me nr. 2540/1 prot., datë 8.10.2025, bëri me dije se është zbardhur leja e ndërtimit nr. 916/7 prot., datë 30.9.2025 nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit sipas vendimit nr. 41, datë 24.12.2024, të Këshillit Kombëtar të Territorit, duke e depozituar atë së bashku me VNM-n paraprake dhe njoftimin e fillimit të punimeve të ndërtimit të impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw dhe veprave ndihmëse.

- Në vijim, me shkresën e datës 22.10.2025, protokolluar në ERE me nr. 2712 prot., datë 22.10.2025, shoqëria “Parisol” sh.p.k. i është drejtuar Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes “OSSH” sh.a., duke vënë në dijeni MIE-n dhe ERE-n me kërkesën për energjizim dhe kryerjen e provës 72-orëshe.

- Gjithashtu, me shkresën e datës 2.12.2025, protokolluar në ERE me nr. 2540/2 prot., datë 3.12.2025, shoqëria “Parisol” sh.p.k. ka bërë me dije se leja e ndërtimit për parkun fotovoltaiik 2mw e shoqërisë “Parisol” sh.p.k. është lëshuar më datë 30.9.2025, si dhe ka kërkuar rishikimin e afatit të përcaktuar në pikën 2, të vendimit nr. 220/2024.

- Referuar afateve të përcaktuara në vendimin 220/2024, bazuar në kontratën e nënshkruar mes shoqërisë “PARISOL” sh.p.k. dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 10511 rep., nr. 4874 kol., datë 28.12.2023, përcaktohet se: “Mbajtësi i miratimit për ndërtim merr përsipër të vërë në punë centralin fotovoltai, brenda 12 muajve nga data e marrjes së të gjitha lejeve për fillimin e punimeve. Afati për pajisjen me lejet e nevojshme në përputhje me rregullat e përcaktuara nga strukturat shtetërore është jo më shumë se 9 muaj nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.”.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në kushtet kur subjekti njofton se është pajisur me leje ndërtimi më datë 30.9.2025 dhe afati i kësaj leje është për një periudhë 12-mujore, atëherë lind nevoja e rishikimit të pikës 2 të vendimit në referencë të afatit të lejes së ndërtimit.

- Me rishikimin e pikës 2 të këtij vendimi, lind nevoja për ndryshimin edhe të pikës 3 të tij, duke specifikuar rrethanat se kur mund të jetë objekt rishikimi ky vendim.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se pikat 2 dhe 3, të dispozitivit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 220, datë 23.10.2024, duhet të ndryshohen dhe duhet të reflektohet situata aktuale e realizimit të projektit.

- Vlerësohet që pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 23/2024, të ndryshohet si vijon: “Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 30.9.2026 dhe jo më vonë se 60 ditë nga fillimi i ushtrimit të aktivitetit duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës.”.

- Me rishikimin e pikës 2 të këtij vendimi, lind nevoja për ndryshimin edhe të pikës 3 të tij, duke specifikuar rrethanat se kur mund të jetë objekt rishikimi ky vendim. Për rrjedhojë, vlerësohet ndryshimi i pikës 3, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 220, datë 23.10.2024, si më poshtë vijon: “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr. 220, datë 23.10.2024, si vijon:

a) pika 2 ndryshon dhe bëhet:

“Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 30.9.2026 dhe jo më vonë se 60 ditë nga fillimi i ushtrimit të aktivitetit duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës.”;

b) pika 3 ndryshon dhe bëhet:

“Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “Parisol” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a., “FTL” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që

mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti